

ROMAN

FILIP NDOGAJ

# VLAGA E DHE UT

837-31  
N 34

FILIP NDOCAJ

837-31  
S.

# VLAGA E DHEUT

Roman

~~45131~~

VALIYERË E SHTËPISË  
DOKTORAS

8573

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: KSENOFON DILO

Tirazhi 8000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISh Shtypshkronjave «Mihal Duri»


Stabilimenti «8 Nëndori» — Tiranë, 1968

NGA CIKLI:  
NIK-BUQAJT E APRIPËS SË KEQE

vëllimi I

«Tu qepemi kodrave e maleve, ti zbukurojmë  
e ti bëjmë ato pjellore si dhe fushat».

**ENVER HOXHA — Raport i mbajtur në  
Kongresin V të PPSH**



I.

**PLAKU I VOTRËS**

Dikur, bregu i majtë i rrjedhës së Drinit, nga vendi ku vërshon Goska ose lumi i Fletit dhe deri aty ku derdhet lumi i Gomsiqes, gjithë kjo zonë e malësisë së Pukës, quhej Dukagjini i Vogël. Megjithëse shumë ma e thyeshme se Përtedrinja, kjo anë gjithmonë ka qenë e banueme së tepërmë. Këtë e tregojnë ajo vazhdimësi katundesh, që ndodhen të vendosuna gjatë këtij bregu, edhe aty ku toka asht fare gurishte dhe e rrëpinët sa me u çuditë; e tregojnë dhe rrenoje të vjetra të nji kohë që s'asht ruejtë as në kujtesën e pleqve. Në këtë breg Drini, katundi ma i vogël dhe ma i thyeshëm asht Apripa e Keqe, dy orë kambësore pa mbërritë te katundi Firëz, ballë të cilit, në bregun e përtejmë të Drinit, vërshon ujët e saj të argjentë Valbona, lumi i Gashit dhe i Krasniqes.

Fill mbas çlirimt, kur ende vendi ishte me armë në dorë tue ndihmë repartet e mbrojtjes për të spastrue malësinë nga bandat e reaksionit, edhe në Apripë të Keqe që ngritë pushteti popullor. Populli i Poravit, i Gropave të Epra e të Poshta si dhe i Apripës së Keqe, u mblodhën në logun e kuvendit të Poravit. Të gjig-

thë njizani zgjodhën për kryetar këshilli Pjetër Ukën e Ukshin Lulashit të Apripës së Keqe<sup>1)</sup>. Por, mbasi Apripa e Keqe dhe Gropat ma shumë se katunde janë lagje të Poravit, disave të poravcëve nuk u erdhi mirë që si kryetar nuk u zgjodh nji nga katundi i tyne; kështu së paku thanë. Por halli i tyne ishte tjetër. Pjetër Uka, si djali ma i madh i komunistit të parë të asaj zone, dëshmorit të luftës nacionalçlirimtare, si partizan i vjetër dhe komunist dhe ai, punën e fillueme nga i ati e kishte vazhdue e po e vazhdonte me kambëngulje e me nji zell të jashtëzakonshëm. Pra, dihej se ai dhe të gjithë Nik-Buqajt, familja e tij, ishin të lidhun ngushtë me partinë, për këtë arësy e edhe populli e zgjodhi kryetar pushteti lokal. Këta «të pakënaqunit» ishin nga nji familje e Poravit, nipa të «zotnive» të Iballës, pari e asaj malësie, gjithmonë të shitun tek i hueji dhe të mësuem me jetue me fitme e gjakësi, vegël e të huejve kundër popullit. Këta poravas nuk dolën haptas kundër Pjetër Ukës, por, sa po mbaroi mbledhja, ja nisën si me shaka:

— Ju koftë për hajër parësia, more Apripë, se gjithmonë keni qenë... fundëria!

Pjetri ishte ndezë, por nji apripas kishte folë në vend të tij:

— Po edhe ju na e dhatë votën, more Porav! E ndigjoni ju, që e mbani veten kryesia e katundit: pu-zgjodhëm për bajraktar por veç me i shërbye popullit, mbasi edhe ka dhanë prova që këtë punë e ban ma mirë se cilido nesh.

Njeni prej po asaj familjeje lëshoi atëherë parullën:

— Hë — de? Tash shpëtuem!

E atëherë Pjetri i ishte turrë atij:

— Prit, kadalë, more kumbarë, se ky qe besa, s'asht tjetër porse fillimi!

1) Të gjithë emnat e kësaj vepre janë të trilluem, po kështu dhe ngjarjet janë përgjithësime e nuk i referohen këtij apo atij katundi (Autori).

*Shuk*

Po atëherë shtëpiaku i asaj familje, Masjan Gjura, tue shikue se puna po merrte dallash e biseda po aca-rohej, ndërhyjni:

— Mos u vê veshin fjalëve të teveqelave të mi, more Pjetër Uka! Ty të koftë për hajr e ma për hajr edhe neve se së bashku do ta vazhdojmë, deri ku të mundemi! — e për me ulë fjalët, kishte vazhdue me dhëlpënинë e njeriut të mësuem me këso ndërhyjmësh:  
— Ne deshtëm me thanë se ju Apripa e Keqe, keni boll hallin e bukës e të jetesës, prandej edhe s'ju ka pasë ra në hise parësia juve.

Por Pjetri ja kishte pre shkurt:

— Po e marr vesh, more Masjan Gjura, se ju keni hallin tem, e... faqebardhë qofshi, se sa më doni edhe ju due! Por ven mend çka jam tue të thanë: Ne boll tokë të këqia kemi, por nuk kemi kenë kurrë vegël e të tjerëve! Apripa me fukarallëk ka jetue vërtetë, por askujt s'i ka ba dam. Por, në e paçi se s'jeni mësue me ra në Apripën e Keqe, e në mos u mbajshin kambët në-për rrëpinat e katundit tonë, mos u mërzitni për kaq pak,... se këshillin do ta ndërtojmë këtu, në mes të katundit tuej... që të mos jua hjekim kryesinë! Jam mësue me ecë unë, e çdo ditë këtu keni për të më pa-së... për çfarëdo halli që të keni. Jena mësue hjekake-që ne, por hapni sytë ju e mos u sillni tepër shpesh në-për katundin tonë, e sidomos natën, se... ban e ju shket kamba e s'ju ndal gja, por shkonit e bini fill e në Dri, pa ju prekë kamba dhé kurrkund!

Pjetri iu drejtë kështu Masjan Gjurës, sepse ato ditë dyshohej se ajo familje strehonte banditë e diver-santë, dhe natën i nxirrte va pa va më anën tjetër të Drinit. E tue u nda prej tij e prej të tjerëve, kishte tha-në:

— E mbasi më zgjodhët kryetar, po të them ty, Masjan Gjura, e cilitdo që ka veshë me ndigjue: Rueni drithin e mos u bani xhymercëtë me ata që vijnë e jua zanë derën! Rrogat e ryshvetet kanë marrë fund e pu-shteti ynë rroga tarafllëku nuk ka, se ligji ynë asht:

kush punon, ha. Dhe unë e kam fjalën sidomos për ata që s'kanë qenë mësue me punue.

S'patën shkue as dy muej nga ajo mbledhje, e nji natë të ftoftë janari Masjan Gjura, që zbriste në breg të Drinit me përcjellë dy diversantë, ra në patrullën e mbrojtjes që udhëhiqej nga Pjetër Uka. Ai, vetë i pesti, me dy djemtë e dy diversantët mbetën të vramë, ndërsa po mundoheshin me barkë llastiku me kalue Drinin.

Kanë kalue bukur disa vjet prej aso kohe dhe vendi ynë ka ndryshue kryekëput; njerëzit kanë përqafue të renë.

Edhe në ato skuta të malësisë gënjeshtrave të reaksionit u ka dalë boja. Malësorët kanë lanë grindjet e hasmënitë e vjetra: ata e kuptojnë tani ndryshe burrëninë.

Por në këto skaje të malësisë e reja ka hy me vësh-tirësi. Apripa e Keqe diçka ka ndryshue, por jo sa viset e tjera. Nga dita kur e patën zgjedhë së parit si kryetar këshilli Pjetër Ukën kanë kalue dhetë vjet dhe Pjetri çdo vit asht rizgjedhë nga populli i asaj zone. E Pjetri ka qenë kurdoherë i gatshëm të çojë në vend çdo porosi të partisë. Ai asht ba copë për të rregullue punët e hallet e katundit dhe asnijherë nuk e ka humbë durimin tue punue me njerëzit e zonës së tij, megjithëse jo pa mundim. Ai ka pasë të bajë me njerëz, në përgjithësi të paarësim, të lidhun ngushtë me zakone të vjetra e paragjykime prapanike, kurse sot ka të bajë me njerëz që nuk arrijnë gjithmonë të shikojnë kjartë të vërtetëtë e ndritun të jetës së re. Edhe atij herë-herë i ka mungue kjartësia e mësimeve të partisë, ka ra vetë në gabime e asht gjetë në udhëkryqe, sepse edhe ai asht i pa-shkollë.

Tani s'ka ma nëpër ato katunde kriminelë, siç qe Masjan Gjura, por ka disa që janë të plogët, indiferentë, njerëz të mefshtë që po ja nxijnë jetën Pjetër Ukës. Shpesh i duhet me humbë ditë e net që t'ua mbushë mendjen për disa punë e arësyetime që, pra, janë të kjarta si rrezja e diellit. E pra, tashti nuk asht i pakra-